



НАРОДНА БАНКА НА РЕПУБЛИКА МАКЕДОНИЈА

Në mbështetje të nenit 48, paragrafi 1, pika 3 të Ligjit të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 158/10, 123/12, 43/14, 153/15, 6/16) dhe pikës 12 të Vendimit për metodologjinë e identifikimit të bankave me rëndësi sistimore ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 26/17), guvernatori i Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë miratoi:

UDHËZIM

për ndryshimin e Udhëzimit për zbatimin e Vendimit për metodologjinë e identifikimit të bankave me rëndësi sistimore ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 34/17)

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Në këto udhëzime përcaktohen më hollësisht zbatimi i Vendimit për metodologjinë e identifikimit të bankave me rëndësi sistimore (në tekstin e mëtejme: Vendimi), përkatësisht:
 - metoda e përcaktimit të vlerësimit përmbljedhës të çdo banke në bazë të ponderit të rëndësisë së kriterëve dhe ponderit të rëndësisë së treguesve.;
 - metoda e përcaktimit të intervaleve dhe të madhësisë së intervaleve të secilës nënkategori me rëndësi sistimore;
 - përmbajtjen e raportit të bankave me rëndësi sistimore.

Shprehjet e përcaktuara në Vendim zbatohen në përputhje me rrethanat në këtë udhëzim.

II. VLERËSIM I PËRMbledhur I Gjendjes së Secilës Bankë

2. Në shtojcën nr. 1 të këtij udhëzimi pasqyrohen ponderët e rëndësisë së kriterëve të rëndësisë sistimore, treguesit sasiorë të përfshirë në katër kriteret e rëndësisë sistimore, mënyrën e llogaritjes së tyre, burimin e të dhënave në bazë të të cilave llogariten këta tregues, si dhe ponderët e rëndësisë së çdo treguesi në kriterin të cilit i përket dhe në llogaritjen totale. Shtojca nr. 1 është pjesë përbërëse e këtij udhëzimi.

3. Vlerësimi përmbljedhës i secilës bankë përcaktohet në këtë mënyrë:
 - vlera e çdo treguesi për secilën bankë merret si raport i pozicionit individual për bankën dhe i njëjti pozicion për të gjitha bankat dhe shumëzohet me 10.000 (shprehet në pikë bazë);
 - mesatarja e vlerës së të gjithë treguesve për çdo bankë të përfshirë në kriterin e caktuar, e përcaktuar në përputhje me nënparagrafin 1 të këtij paragrafi, jep vlerën e secilit kriter me rëndësi sistimore;
 - mesatarja e vlerës së të gjitha kriterëve, e përcaktuar në përputhje me nënparagrafin 2 të këtij paragrafi, jep vlerësimin përmbljedhës për çdo bankë.

Shuma e vlerave të të gjitha bankave brenda kriterëve të veçanta me rëndësi sistimore dhe brenda vlerësimit përmbljedhës është 10.000 pikë bazë.

4. Të gjitha bankat, vlerësimi total i të cilave sipas llogaritjes me gjendjen e 31 dhjetorit është i barabartë ose më i madh se kufiri prej 350 pikë bazë, paraqesin banka me rëndësi sistemore

5. Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë (në tekstin e mëtejshëm: Banka Popullore) i publikon bankat me rëndësi sistemore në faqen e saj të internetit, në afatet e përcaktuara me ligj.

III. INTERVALE TË ÇDO NËNKATEGORIE TË RËNDËSISË SISTEMORE

6. Çdo bankë me rëndësi sistemore sistemohet në një nga pesë nënkategoritë e rëndësisë sistemore.

Nënkategoritë me rëndësi sistemore përcaktohen në këtë mënyrë:

- vlera minimale e nënkategorisë së parë me rëndësi sistemore është e barabartë me 350 pikë bazë;
- vlera maksimale e nënkategorisë së pestë është shuma e vlerësimit përmbljedhës të bankës me rëndësinë më të lartë sistemore deri më 31 dhjetor 2016 (2.471 pikë bazë) dhe devijimit standard nga vlerësimet përmbljedhëse të bankave të identifikuar me rëndësi sistemore (708 pikë bazë);
- intervalet për secilën nënkategori me rëndësi sistemore përcaktohen duke pjesëtuar me 4 dallimin ndërmjet vlerës maksimale të paragrafit 2 të këtij paragrafi (3.178 pikë bazë) dhe vlerës minimale të paragrafit 1 të këtij paragrafi (350 pikë bazë) dhe kjo vlerë (707 pikë bazë) i shtohet kufirit të poshtëm të çdo nënkategorie me rëndësi sistemore.

Këto përlogaritje kanë të bëjnë me të dhënat e 31 dhjetorit 2016, me ç'rast kufijtë e nënkategorive me rëndësi sistemore janë fikse më së voni deri në llogaritjen me gjendjen më 31 dhjetor 2018.

Për çdo nënkategori me rëndësi sistemore, parashikohet një nivel i ndryshëm i shtresës mbrojtëse të kapitalit për bankat me rëndësi sistemore, nga 1% deri 3,5%. Në shtojcën nr. 2 janë dhënë intervalet e secilës nënkategori me rëndësi sistemore dhe sasia e shtresës mbrojtëse të kapitalit për bankat me rëndësi sistemore. Shtojca nr. 2 është pjesë përbërëse e këtij udhëzimi.

IV. RAPORTIM I BANKAVE ME RËNDËSI SISTEMORE

7. Raportimi që Banka Popullore, në përputhje me ligjin, i dërgon bankës që identifikohet si bankë me rëndësi sistemore, përmban shkallën e shtresës mbrojtëse të kapitalit për bankat me rëndësi sistemore që banka duhet të mirëmbajë, së bashku me shpjegimin e mënyrës se si përcaktohet shkalla e shtresës mbrojtëse të kapitalit për këtë bankë me rëndësi sistemore

V. DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

8. Ky udhëzim hyn në fuqi tetë ditë pas botimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë.

U nr. 8291
15 mars 2017
Shkup

Guvernatori
Dimitar Bogov

Shtojcë nr. 1

Kritere të rëndësisë sistemore dhe tregues sasiore (me ponderë të rëndësisë dhe shpjegim të mënyrës së llogaritjes së treguesve)

Kriter i rëndësishëm sistematik (ponder i rëndësishëm)	Tregues (llogaritjet për çdo bankë, si raport i pozicionit të veçantë për secilën bankë dhe të njëjtit pozicion në nivel të sistemit bankar)	Përshkrim i pozicioneve individuale (gjendja më 31 dhjetori, përveç nëse përcaktohet ndryshe)	Burimi i të dhënave (B*, BPRMV** dhe/ose Ç***)	Ponder i treguesit brenda kriterit	Ponder i treguesit në llogaritjen totale
Madhësia (25%)	Aktivitetet bilanci dhe jashtë bilanci	Shuma neto e ekspozimit total të bilanci dhe jashtë bilanci të paraqitur në formularët APKR nga rregullorja e Bankës Popullore për përcaktimin e mjaftueshmërisë së kapitalit.	B	100%	25%
Ndërrueshmëria (25%)	Ekspozimi kreditor ndaj personave jofinanciarë	Ekspozimi kreditor ndaj shoqërive jofinanciare dhe amvisërive, i përcaktuar në përputhje me rregulloren e Bankës Popullore për menaxhimin e rrezikut kreditor dhe regjistrin e kredive.	B	25%	6,25%
	Depozitat e personave jofinanciarë	Mjetet në llogaritë rrjedhëse (të transaksionit), depozitat pa afat, depozitat afatshkurtra dhe afatgjata (përfshirë depozitat e kufizuara) të shoqërive jofinanciare dhe të amvisërive.	B, BPRMV	25%	6,25%
	Ekspozimi kreditor ndaj 20 debitorëve më të mëdhenj jofinanciare në nivel të sistemit bankar	Ekspozimi kreditor ndaj 20 debitorëve më të mëdhenj jofinanciarë në nivel të sistemit bankar (pa marrë parasysh palët e lidhura), i përcaktuar në përputhje me rregulloren e Bankës Popullore për menaxhimin e rrezikut kreditor dhe regjistrin e kredive.	B	25%	6,25%
	Qarkullimi brendabankar i pagesave	Vlera e transaksioneve të pagesave në qarkullimin e pagesave brendabankare, e paraqitur si mesatare mujore e vlerës së transaksioneve të pagesave gjatë vitit.	B	25%	6,25%
Lidhshmëria (25%)	Qarkullimi i tregut ndërbankar	Shuma e kredive të dhëna dhe të marra, depozitave e të ngjashme, të tregut ndërbankar të vendit, përfshirë transaksionet repo gjatë vitit.	B, BPRMV	33,3%	8,33%
	Qarkullimi i tregut valutor	Qarkullimi në këto segmente të tregut valutor: ndërmjet bankave, ndërmjet bankave dhe Bankës Popullore dhe ndërmjet bankave dhe personave të tjerë (transaksione pa para të gatshme me persona juridikë dhe fizikë, rezidentë dhe jorezidentë) gjatë vitit.	B, BPRMV	33,3%	8,33%
	Qarkullimi i pagesave nëpërmjet sistemeve të pagesave	Vlera e transaksioneve të pagesave përmes sistemeve të pagesave MIPS, KIBS dhe CASIS. Vlera e transaksioneve të pagesave paraqet mesataren mujore të vlerës së	BPRMV, D	33,3%	8,33%

		transaksioneve të pagesave për dymbëdhjetë muajt e vitit.			
Ndërlikueshmëria (25%)	Vendosjet në dhe detyrimet ndaj institucioneve financiare jashtë vendit	Mjetet në llogaritë rrjedhëse në bankat e huaja, depozitat e investuara në bankat e huaja, kreditë e dhëna bankave të huaja dhe institucioneve të tjera financiare të huaja, investimet në letrat me vlerë të borxhit dhe kapitalit të emetuara nga bankat e huaja dhe institucionet e tjera financiare të huaja, si dhe detyrimet e regjistruara në llogaritë rrjedhëse të bankat e huaja, depozitat nga institucionet financiare të huaja, detyrimet e bazuara në kredi për institucionet financiare të huaja dhe detyrimet e bazuara në instrumente hibride dhe instrumente të varura ndaj bankave të huaja dhe institucioneve të tjera financiare të huaja.	B, BPRMV	50%	12,5%
	Qarkullimi i pagesave jashtë vendit	Vlera e të gjitha pagesave ndaj dhe e arkëtimeve nga jorezidentët gjatë vitit .	B, BPRMV	50%	12,5%

* Të ofruara nga banka.

** Llogaritjet e Bankës Popullore në bazë të të dhënave të ofruara nga bankat.

*** Institucione të tjera.

Shtojcë nr. 2**Shtresa mbrojtëse e kapitalit për çdo nënkategori me rëndësi sistimore**

Nënkategori me rëndësi sistimore	Interval	Shtresë mbrojtëse e kapitalit për bankat me rëndësi sistimore
5	mbi 3.097	3,5%
4	mbi 2.471 deri 3.178	2,5%
3	mbi 1.764 deri 2.471	2,0%
2	mbi 1.057 deri 1.764	1,5%
1	350 deri 1.057	1,0%